



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË I
OSNOVNI SUD PEC - OGRANAK ISTOK BASIC COURT OF PEJA-BRANCH IN I

P.nr.11/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA I - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares Juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit R A, f.sh. K nga K-I, i akuzuar për shkak të veprës penale “ Ngasje ne gjendje te paafte apo te dehur nga neni 371 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, me PP/II.nr.1738/2019, e dt.27.12.2019, në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të mbajtur me dt.**25.02.2020**, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Suada Hamza, të pandehurit R A dhe mbrojtësit të tij, Av. Pranvera Ukaj nga Iu, Gjykata të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me dt.27.02.2020, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R A** i lindur me ... ne fsh. K K- I, tani me banim ne I, rr. “ ..” , i biri i S dhe nënës S e gjinisë H, i martuar, baba i një fëmije, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë te letërnjoftimit me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i dënuar edhe ma parë nga Gjykata, gjendet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën 03.03.2019 rreth orës 14:00 ne aksin rrugorë në f.sh, O-S, K I, derisa ishte duke drejtuar veturën e tipit P me targa, nen ndikimin e alkoolit prej 2.68 promila ne gjak, dhe kur arrin në vendin e lartcekur humb kontrollin mbi veturë, me ç rast ka shkaktuar vet aksidentin duke dalë nga rruga ku bije ne një kanal nen rruge, dhe si pasoj e kësaj i shkaktohen lëndime te lehta trupore pasagjerit te tij te dëmtuarit M A,

- me çka ka kryer vepër penale, “ Ngasje ne gjendje te paafte apo te dehur nga neni 371 par.2 të KPRK-së,

Gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit, 7,8,9,10,17,23,40,42,48,64,69,70 dhe nenit, 371 par.2, si dhe nenit 233, 359, 360, 361, 365, 366, 450 të KPPRK, të pandehurin e Gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që:

1.Të pandehurit **R A**, Gjykata i përcakton dënim me **burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet, ne qofte se në afatit ligjor prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, i njëjti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

2.I pandehuri obligohet që në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej **20 (njëzetë) euro**, paushallin gjyqësor në shumën prej, **20 (njëzetë) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tridhjetë) euro**, të gjitha në afatin prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3.I dëmtuari **M A** me vendbanim ne f.sh. K K I, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil

4. Konform nenit 64 par.1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit R A i shqipton dënim Plotësues "Ndalimi i drejtimit të automjetit për kategoritë: B1.B.M.L.T, në kohëzgjatje prej **1(një) viti**, duke llogaritur nga dita kur aktgjykimi e merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Përgjithshme, pranë kësaj Gjykate ka ngritë aktakuzën me PP/II.nr.1738/2019, dt.27.12.2019, ndaj të pandehurit R A, nga f.sh. K K. I, duke e akuzuar për vepër penale, "Ngasje ne gjendje te paafte apo te dehur nga neni 371 par.2 të KPRK-së, ku së bashku me aktakuzë, në gjykatë është dorëzuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në prokurori në mes të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij, me datë 24.12.2019, me propozim që i akuzuari të dënohet me dënim me kusht si dhe ti shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 1 viti.

Gjykata me datën 25.02.2020, mbajti seancën për shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në praninë e Prokurorit të Shtetit Suada Hamza, të pandehurit R A dhe mbrojtësit të tij, Av. Pranvera Ukaj nga I, e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë e ka vlerësuar së marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur konform nenit 233 par.16,18 dhe 21 të KPPRK-së dhe pasi që është bindur që e njëjta është e bazuar në ligj të njëjtën me aktvendim në procesverbal e ka aprovuar.

Meqenëse gjykata e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, para së të kalojë në vendimin mbi dënim i ka ftuar palët që të deklarohen lidhur me dënimin.

Prokurori i shtetit deklaroj se qëndroj pranë përmbajtjes së marrëveshjes të arritur në prokurori me dt.24.12.2019, e cila marrëveshja është përpiluar komform dispozitave ligjore nga neni 233 të KPPK-së dhe e njëjta po ashtu është arritur në prezencën e mbrojtësit dhe të pandehurit, andaj si e tillë kërkoj që nga ana e gjykatës të aprovohet dhe të njëjtit të shqiptohet dënimi kryesor në kuadër të marrëveshjes dhe po ashtu të shqiptohet edhe dënimi plotësues i propozuar si në marrëveshje, ndërsa sa i përket lartësisë së dënimit të mbetet në diskrecion të gjykatës.

Mbrojtësja e të akuzuarit avokatja Pranvera Ukaj deklaroj se qëndroj në tërësi pranë marrëveshjes, e cila është arritur me pajtimin e të mbrojturit tim, dhe i propozoj gjykatës që klientit tim të shqiptoj dënimi i paraparë në kuadër të marrëveshjes mbi pranimin fajësisë.

Ë akuzuari R A deklaroj se në tërësi pajtohem me marrëveshjen për pranimin të fajësisë të cilën e kam lidhur me vullnetin, jam përdorur për veprën penale të kryer, ju premtoj se në të ardhmen nuk do të bëjë ndesh me ligjin.

Me faktet e ofruara si dhe duke marrë për bazë arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri, R A, me datën 03.03.2019 rreth orës 14:00 në aksin rrugorë në f.sh. O S, K I, duke drejtuar veturën e tipit P me targa ..., nën ndikimin e alkoolit prej 2.68 promila në gjak, e humb kontrollin mbi veturë, me ç' rast ka shkaktuar vet aksidentin, ku ka dalë nga rruga duke rënë në një kanal nën rrugë, me ç' rast i shkaktonte lëndime të lehta trupore pasagjerit të tij të dëmtuarit M A,

Gjykata duke marrë për bazë arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka ardhë deri të gjendja faktike se në veprimet e të pandehurit R A, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Ngasje në gjendje të paafte apo të dehur nga neni 371 par. 2 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën penale nga pakujdesia e vetëdijshme pasi që ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mos veprimit të tij, por me mendjelehtësi ka menduar se ajo nuk do të shkaktohet apo mund ta parandaloj shkaktimin e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitë rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale me të cilën akuzohet.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe mbi këtë bazë ka arritur marrëveshjen, është përdorur për veprën penale të kryer, ka treguar sjellje të mira në gjykatë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do bëjë ndesh me ligjin.

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur faktin se i pandehuri ka qenë i dënuar edhe me parë nga kjo Gjykatë sipas aktgjykimit të plotfuqishëm me Pnr.194/19 i dt.23.12.2019, për veprën penale të dhunës në familje ku është dënuar me dënim me gjobë prej 300 euro dhe dënim me burgim të kushtëzuar.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK

Dënimi plotësues Ndalimi i drejtimit të automjetit është shqiptuar Konform nenit 64 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor të cekur si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata i ka udhëzuar të dëmtuarin në kontest të rregullt juridiko-civil, në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA I
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
P.nr.11/20 më datë 25.02.2020**

Sekretarja Juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari

Arben Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës se Apelit ne Prishtine e përmes kësaj Gjykate.